



Shoqata e Matematikanëve të Kosovës
Kosovar Mathematical Society

RREGULLORE PËR ÇMIMIN: MEDALJE E KARRIERËS NË MATEMATIKË

I. TË PËRGJITHSHME

1. Çmimi "Medalje e Karrierës në Matematikë" është themeluar nga Shoqata e Matematikanëve të Kosovës, më 13.06.2019, me qëllim që të nderoj kontributin jetësor në matematikë të mësimeve të matematikës të arsimit universitar.
2. Çmimi "Medalje e Karrierës në Matematikë" do të synohet të jepet çdo vit, duke filluar nga viti 2019. I njëjti çmim "Medalje e Karrierës në Matematikë" do të jepet edhe në kategorinë "Post-mortum".
3. Një person nuk mund të fitojë çmimin më shumë se një herë.
4. Çmimi i jepet matematikanëve që kanë kontribuar në arsimin universitar në Republikën e Kosovës.
5. Bazë kryesore për dhënien e çmimit do të jetë kontributi i mësimeve në zhvillimin e matematikës në Kosovë.
6. Çdo propozim për ndryshim të kësaj rregullore duhet të paraqitet në mbledhje të rregullt të Bordit të Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës. Për të hyrë në fuqi ndonjë propozim, duhet të marrë mbështetjen e shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

II. PROCEDURA PËR NDARJEN E ÇMIMIT: MEDALJE E KARRIERËS NË MATEMATIKË

1. Kryetari i Shoqatës e cakton komisionin për ndarjen e çmimit.
2. Komisioni përbëhet prej 3 anëtarëve të Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, njëri prej të cilëve nuk duhet të jetë anëtar i Bordit të Shoqatës.
3. Anëtari me thirrjen më të lartë akademike zgjidhet drejtpërdrejtë kryetar i komisionit.
4. Në rast se dy ose më shumë anëtarë të komisionit i kanë thirrjet akademike të njëjta, atëherë kryetar i komisionit zgjedhet personi që është më i moshuar.


5. Kryetari i Shoqatës dhe anëtarët e komisionit për ndarjen e çmimit nuk mund të jenë fitues të çmimit në vitin në të cilin shërbejnë.
6. Komisioni, Bordit të Shoqatës i paraqet raportin unanim me shkrim. Ky raport ofron një rekomandim me një mësimdhënës për t'u konsideruar si fitues i çmimit, i shoqëruar nga një përshkrim i hollësishëm për kontributin e kandidatit. Nëse Komisioni nuk arrin të marrë një vendim unanim, çmimi nuk do të jepet atë vit.
7. Bordi i Shoqatës, me shumicë votash, aprovon raportin e komisionit. Me këtë rast kryetari nënshkruan vendimin për dhënien e çmimit.
8. Dështimi i Bordit për të aprovuar, me shumicë votash, raportin e komisionit, konsiderohet i barazvlefshëm me vendimin që çmimi të mos jepet atë vit.
9. Pas ndarjes së çmimit, vendimi për ndarjen e çmimit së bashku me raportin e komisionit, do të publikohen në webfaqen e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës.

III. SHPËRBLIMI

- 1 Fituesi i çmimit do të pranoj një Medalje, një Diplomë dhe në rast të mundësive financiare të Shoqatës, edhe një shumë të hollash (dhuratë) në vlerën që përcaktohet nga Bordi i Shoqatës. Përfaqësuesi i fituesit të çmimit në kategorinë "Post-mortum" do të pranoj një Medalje dhe një Diplomë.

Dr. sc. Armend Shabani, Profesor asistent

Prishtinë, 08.07.2019



Kryetar i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës